



PROCESVERBAL 1/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.01.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani

Z. Bashkim Ndrecaj

Z. Brahim Curri

Z. Alban Berisha

Z. Shefket Kolgeci

Z. Xhemajl Kabashaj

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj. Shqipe Ramaj

Z. Lirim Qatani

Z. Reshat Selimaj

Z. Ardian Kotorri

Z. Bexhet Kuçi

Z. Aziz Bytyqi

Z. Gazmend Gashi

Znj. Bardha Gashi

Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi

Z. Jeton Rrakaqi

Z. Arbërim Basha

Z. Dardan Berisha

Znj. Marigona Gashi

Znj. Florie Bytyqi

Z. Sami Hajdari

Znj. Albana Bytyqi

Z. Osman Selimaj

Z. Leonard Shala

Z. Dugagjin Palushi

Znj. Laureta Tafaj

Z. Gëzim Kryeziu

Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë
Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Habibe Bytyqi
Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores,01-nr-16-7790 për ndarjen e bursave për nxënës /e dhe studentë /e të Komunës së Suharekës;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve financiare;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Duhël;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Gelancë;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Shirokë;**
7. **Informatë për aktivitet e KKS-së**
8. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi – përshëndet të pranishmit dhe ne hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Sami Hajdari – përshëndet të pranishmit.Desha të ju njoftoj që prej sot unë do të jem anëtar i PDK-së.

1. **Pika Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Kryesuesi – e hedh në votim Pikën 1.

Miratohet Procesverbali

Pika 2 Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores,01-nr-16-7790 për ndarjen e bursave për nxënës /e dhe studentë /e të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi – e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Aziz Bytyqi–përshëndet të pranishmit. Siq tha Kryesuesi, kjo pikë është diskutuar mjaft.Falemderon Nexhat Ramadanin,Dardan Berishën dhe përfaq.e Iniciativës Qytetare të cilët kanë dhënë kontributin në ndryshimin e dy pikave.Është bërë një gabim teknik te pika 8.2.3.Nota mesatare 7.5-8.49 vlerësohet me 15 pikë.Pra kjo rregullore është e ekuilibruar në aspektin social dhe cilësor.Iu uron suksese kandidatëve për deputetë.

Jeton Rrakaqi –përshëndet gjithë të pranishmit. Ne si grup parlamentar e kemi dërgu Dardanin dhe i besojmë kontributit të tij.

Dugagjin Palushi – përshëndet të pranishmit. Te pika 8.2.20 ,studentët që nuk kanë asnjërin prind të punësuar dhe nuk kanë asnjë të ardhur vlerësohen me 15 pikë. Mendoj që kjo kategori të vlerësohet sikur te rastet sociale, me 30 pikë.

Florije Bytyqi – përshëndet gjithë të pranishmit. Jam pro rregullores, por kam vërejtje te neni 8.21. Mos është e tepërt nota mesatare 9.5-10, sepse pak studentë mujn me i arrit këto pikë. Ju lutem nëse ka mundësi për përmirësim.

Nexhat Ramadani – përshëndet të pranishmit. Siq tha edhe Azizi, kemi pas ni takim ku kemi diskutu dhe jemi dakordu për ni rregullore e cila ndoshta nuk është perfekte por përfshin edhe anën sociale dhe cilësore. Ne si grup parlamentar e mbështesim.

Avni Bytyqi -si zyrtar ligjor jep sqarime studentët me note mesatare 6 deri 6.99 dhe nxënësat me note mesatre 2 deri 2.99 nuk janë të përfshirë në rregullore. Kjo është në kundërshtim me konventën e të drejtave të fëmijëve, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, poashtu është në kundërshtim me Rregulloren që vet ky kuvend e ka miratu në 2019-tën e qe ka te bene me mbrojtjeten e te drejtave te femive, si dhe me kontraten per te drejtate e njeriut Andaj është mië të përfshihen dhe të poentohen me poena minimale edhe keto kategori.

Aziz Bytyqi – Është keqkuptu. Studenti që ka mesataren 6.99 ,që është me asistencë sociale nuk i prejashtohet mundësia por i merr 30 pikë me asistencë sociale, mirëpo për cilësi nuk vlerësohet.

Dardan Berisha – edhe në rregulloren e kaluar kanë qenë të përjashtuar nxënësat me mesatren 2 e tutje. Shikoje mirë zyrtar ligjor është e njejta.

Avni Bytyqi – kjo rregullore ka mundësi me u kthi në rishqyrtim nga Ministria, për arsye se unë kam konstatuar që është në kundërshtim me dispoziten ligjore.

Aziz Btyqi – unë e thashë shumë qartë.

Laureta Tafa – përshëndet të pranishmit. Unë si anëtare e këtij kuvendi, a nuk kam të drejtë me u informu për këtë ndryshim në rregullore? Kërkoj përgjigje.

Kryesuesi - Ne kemi pas ni debat publik, ku janë informuar të gjithë. kemi shku por nuk ka ardh askush.

Shefket Kolgeci – përshëndet të pranishmit. Unë mendoj që kësaj kategorije prej 2-2.99 dhe 6-6.99 ti jepen 5 pikë dhe ti jepet mundësia, që të mos bëjmë diskriminim.

Dardan Berisha – u ndërlidha me kolegun dhe nuk ma merr mendja që kjo rregullore jep mundësi, sepse janë organe tjera kompetente për mos me lan asnjë fëmijë pa shkollim. Lauretës i them që ne kemi shty një seance për këtë rregullore, për këtë ndryshim dhe kemi qenë të informuar të gjithë ku dhe është mbajt një takim. Ndoshat kjo rregullore ka mangësi por duhet të kalojë.

Jeton Rrakaqi – secili grup parlamentar kemi dërguar nga një koleg, dhe më duket e pa arsyeshme.

Dugagjin Palushi – mendoj që këto propozime të hidhen në votim. Nëse Avniu thotë që këta fëmijë diskriminohen, të paktën tu jepen 3 pikë. Pastaj edhe propozimi i doktorreshës.

Xhemajl Kabashi – dëgjova debatin me vëmendje. Është rregullore e kompletuar, por jo ideale. Unë mendoj që të qitet ni paragraf në rregullore edhe për nxënës dhe për studentë, që edhe ata me pas të drejtë.

Aziz Bytyqi- s'kam asnjë konflikt interesi. Të thuhet se po e prejashton, nuk e pranoj si profesionist dhe nuk ka asnjë despozitë që prejashtojnë studentët nën mesatre 7 dhe nxënësit nën mesatare 3.

Kryesuesi – e hedh në votim me këto ndryshime:

Studentët me mesataren 6 deri 6.99 dhe nxënësit me mesataren 2 deri 2.99 të vlerësohen me 3 pikë.

Pika 3 Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri - alokimin e mjeteve financiare;

Kryesuesi – e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Jeton Rrakaqi – në kuadër të kësaj kërkesë për ndarje të mjeteve për KF”Ballkani” në vlerë 88.000 euro megjithëse kërkesa nuk i drejtohet Asamblesë por Kryetarit të Komunës.Kërkoj sqarime për këtë kërkesë.

Kryetari – përshëndet të pranishmit dhe i uron suksese kandidatëve të partive politike për deputet në parlamentin e Kosovës.Falemnderon Sami Hajdarin për bashkëpunimin.Është një kërkesë prej KF Ballkanit drejtuar Asmblesë dhe Kryetarit të Komunës.Është mire ti ndihmojmë sepse ky klub garon për vend të parë.Kemi disa mjete që kanë mbet prej vitit 2019 dhe vlera përafërsisht është 80.000 euro.Kemi bo kërkesë që këto mjete të shkojnë në subvencione.Kërkoj përkrahje nga ju.

Jeton Rrakaqi – Sa i përket sportit,ne si grup parlamentar çdo here i kemi mbështetë.Mendoj që është lluksi i madh me u nda kjo shumë kaq e madhe në këtë kohë pandemie.Kush mundet me i ndal klubet tjera që me bo kërkesa të ngjashme,ku kemi mjaft klube të suksesshme.Në QKMF nuk kemi preparate për trajtimin e Kovidit.Një pjesë prej 38.000 eurove të ndahen në sport dhe të shkojnë në mënyrë proporcionale dhe jo në mënyrë individuale.Në emër të grupit parlamentar kërkoj që 50.000 të shkojnë në shëndetësi.

Nexhat Ramadani – ne kemi një projekt-vendim që na ka qit në siklet të gjithëve.Unë edhe në KPF e kam pyet Kryetarin se cila është arsyeja për bartjen e këtyre mjeteve, dhe Kryetari e ka shpreh hapur që këto mjete ti shkojnë KF”Ballkanit”.Nuk jemi kundër por vlera prej 80.000 euro është e papranueshme.Ju si kryetar duhet ta shihni njëherë mire gjendjen dhe me pa dej ku është mundësia, dhe të na mbroni neve asambleistëve,e jo të na qitni në kësi pozita.Kërkoj që këto mjete të ndahen në mënyrë proporcionale. 30.000 euro të ndahen për subvencionimin për sportin në mënyrë proporcionale,30.000 të ndahen për shëndetësinë për Kovid,dhe një pjesë prej 20.000 eurove të ndahen për vërshimet.

Jeton Rrakaqi – Kryetar mos na qitni në kësi pozita sikur me teatrin.Të thoni jam pro,por vendos Asamblea.Nuk jemi kundër KF Ballkanit.Kam pas edhe një kërkesë në KPF, ku ju nuk e keni miratu.Me një fushat ku jemi sot,po tentohet me bo politikë.Jo politikë prej sportit!

Dardan Berisha – shihet ndërhyrja dhe qasja politike.Ballkani nuk ka pas ndonjë sukses të veçant që ne me u krenu.Por sikur t’kish qenë para falimentimit e kishim përkrah.Shkuarja në Turqi më duket shumë lluks.

Laureta Tafa – pasi parafolësit paten mendime të njejta si unë.A bon Kryetar 20.000 euro me ja nda këtij djali që kërkon shërim, 20.000 euro të ndahen nëpër fshatra ku ka pas vërshime dhe ku është shemb ura në fshatin Njëpërbisht.Shumë e du sportin ,por të mendojmë njëherë për ta.

Leonard Shala – ne sot jemi tu votu bartjen e mjeteve në subvencione,dhe nuk jemi tu nda mjete për KF”Ballkanin”.Mbi 5.000 euro mjete nëse dojm me i nda duhet me pru në Asamblenë Komunale.Në parim jam me Nexhatin e të tjerët,por më duket diskriminuese kur flasim për Ballkanin.Me sa e di, drejtorija për Rini Kulturë dhe Sport afërsisht ka 100.000 euro mjete të cilat i ndan për sport.Unë nuk di që naj here ka marrë mjete KF”Ballkani”.Pavarësisht që funksionon si Sh.p.k.,edhe Ballkani është klubi jon,po korr suksese dhe duhet të jemi krenar me të.

Arbërim Basha – të gjithë jemi me Ballkanin,të gjithë jemi me futbollin por në sport nuk ka politikë.Kryetar,që sa vite nuk i ke përkrah sportet tjera?Leonard,as ti nuk e don Ballkanin më shumë se unë,sepse kur i kam propozu parcellat për Ballkanin dhe jam kanë për mi dhanë,ti ke qenë kundër,ke bo politikë.Futbollin,sportin e mbajnë bizneset.Jam me Ballkanin dhe e du

Ballkanin,mirëpo këto 80.000 euro në këtë kohë pandemie,e edhe vërshimeve që patëm!Nëse del e thotë që nuk kam para,atëherë krejt e përkrahim.

Leonard Shala – Arbërim,ti më the që nuk e dua Ballkanin.Unë jam djali i Dërvish Shalës,futbollistit të pare.Ne si familje e gjerë e kemi përkrah e mbajt me vite e dekada KF “Ballkanin”.Unë personalisht kam pas biznes dhe i kam ndihmu sportet.Nuk është e vërtetë që kam qenë kundër parcellave.

Arbërim Basha – e ke marrë shumë personal.Kam respekt për Dërvish Shalën.

Bashkim Ndrecaj – ne kemi dal jasht debatit.Nuk ka nevojë të përmendet Ballakani dhe Cima.Ne sot jemi për mi aloku këto mjete dhe unë jam pro këtij projekt-vendimi.Kur të vje propozimi se kujt me ja nda këto mjete atëherë mund të debatojmë.

Xhemajl Kabashi – Bashkimi e tha me vend që nuk duhet të debatohet,sepse sot po vendoset për rialokim të mjeteve nga fondet vetanake në subvencione në vlerë 80.000 euro.Nëse jemi për këtë ndryshim sot,unë do e mbështes,dhe mesiguri Kryetari ose ekzekutivi do t’na bje në seancën tjetër propozimin se ku do të destinohen këto mjete.

Nexhat Ramadani – ne e kemi të qart se sot është vetëm bartja,por ideja juaj është mi qu atje.Nuk është dasht me qit atë kërkesë.

Kryetari – më ke peyt në Komitet dhe ta kam dhanë përgjigjen.Është komisioni që ndihmon shëndetësinë.Rastin në Sopijsë e kemi ndihmu,edhe për rastin në Shirokë kemi bisdu me Halil Kastratin.Është drejtorja e shëndetësisë ku bohen kërkesat.Të gjithëve ju kemi ndihmu me mundësi.Te subvencionet e vitit të kalum,shikoni letrat,të gjitha klubeve sportive ju kemi ndihmu ngapak.Dua të them diqka;Ballkani e ka ngrit Suharekën. Nuk jam tu bo politikë.

Nexhat Ramadani – çdo projekt-vendim që vje duhet me pas arsyetim.Para se me votu unë duhet ta di se ku do të shkojnë këto mjete.Nuk jam kundër dhe pikërisht për këtë e dhash një propozim.

Agim Bylykbashi – patjetër duhet të barten këto mjete prej projekteve kapitale në subvencione e pastaj me marr vendim kuvendi se kujt do me ja nda këto mjete.

Nexhat Ramadani – po i përsërit të njetat fjalë.Ju si drejtor i Financave duhet me dhan arsyeshmërinë e këtij vendimi.

Kryetari – sot e ceka në mënyrë publike dhe është hera e tretë.Kemi nda vitin e kalum 300.000 euro për dame me ndihmën edhe të ministriesë.

Jeton Rrakaqi - kërkesa është për stafin e Kf “Ballkanit”prej 45 personave për shkuarjen në Durrës për 11 ditë dhe në Turqi për 14 ditë.Sipas rregullores stafi duhet të jetë prej 32.Nuk jam kundër shkuarjes në Turqi.Tash nuk është sezona,dhe me këtë staf që e përmenda nuk e kalon vlerën 40.000 euro.

Xhemajl Kabashi – ne e dime në qfarë gjendje ka qenë KF”Ballkani” dhe si është tash.Të gjitha shpenzimet që i bën në ndërtim i investon në sport.Unë e votoj për 500.000 e jo për 80.000,sepse shpenzime ka shumë.

Jeton Rrakaqi – e dini se çfarë kontributi kemi dhënë për sportin.Ju lutem mos na qitni në sy keq.

Kryesuesi – e hedh në votim

**11 për , 6 kundër 2 apstenime
Miratohet**

Pika e 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Duhël

Kryesuesi – e elaboron këtë pike dhe e hap debatin.

Kryesuesi – nuk ka debat,e hedh në votim.

**20 për , 1 kundër 2 apstenime
Miratohet**

Pika e 5 Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Gelancë

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe e hap debatin.

Jeton Rraçaqi – Ne emër të grupit parlamentar e mbështesim.

Pronari i fabrikës “Frutex” ka kërku një pronë për destinim humanitare në zonën industriale në Shirokë, e cila nuk ju ka aprovu. Unë jam shumë i shqetësuar dhe nuk kam qenë në dijeni Ai ka shkruar një letër të cilën do e lexoj.” Unë tani kam vendos me ndërtu fabrikën në Prishtinë dhe kam fillu me procedurat për leje, dhe jam shumë i zhgënjyer për kontributin që kam dhënë në Komunën e Suahrekës.

Kryesuesi – a a ka të bëjë me këtë prone këtu.

Jeton Rraçaqi – ai ka bo kërkesë tjetër kund dhe nuk iu ka aprovu.

Kryesuesi – e hedh në votim

16 për, 2 kundër Miratohet

Pika e 6 Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike Komunale në Shirokë;

Kryesuesi – e elaboron këtë pikë dhe e hap debatin.

Dugagjin Palushi - jo vetëm te kjo por te trijat, komisioni nuk iu ka përmbajtur afateve ligjore.

Avni Bytyqi – ka ndryshuar ligji për dhënie në shfrytëzim të pronës aftshkurtër dhe aftgjatë, ku tani është 15 ditë.

Dugagjin Palushi – pse është përzgjedh dikush që është me kushte dhjetë here më te disfavorshme?

Emrush Bytyqi – përshëndet të pranishmit. Bazuar në vendimin e komisionit dhe bazuar në vendimin e asamblesë komunale, komisioni ka vendos kushte dhe kritere për marrjen në shfrytëzim të kësaj parcele, dhe si kriter është vlerësimi i përqindjes së pikëve për çdo kriter.

Avni Bytyqi – sipas elaborimit të këtij rasti që bëri Jetoni, ku tha se kërkesa ka qenë në kundërshtim që është e paraparë në bazë të planit rregullues, komisioni për këtë arsye nuk ja ka dhanë në shfrytëzim Frutex-it.

Xhemajl Kabashi – si operatorë ekonomikë i asaj zone, nuk favorizohen me një 5 pikësh apo 10 pikësh, ndërsa ata që janë për herë të pare stimulohen me 10 pikë, dhe kjo ka ndiku që totalin e pikëve ta fitoj ai.

Dugagjin Palushi – nuk është parapa debo ndërtimore por depo ushqimore. Le të na tregoj Kryesuesi se qka ka me bo ai sipas planit të biznesit.

Kryesuesi – depo ushqimore.

Kryesuesi – e hedh në votim.

**12 për, 3 kundër 2 apstenime
Miratohet**

Pika 7 Informatë për aktivitet e KKSB-së

Kryesuesi – e laboron këtë pikë.

Pika e 8 Pyetje dhe pergjegje

Gëzim Kryeziu – kam kërkesë nga qytetarët e Suharekës të cilët kanë qenë të prekur nga Kovid. Vetëm ata të cilët kanë raport nga IKSHP-ja iu pranohet kompenzimi. Ka shumë raste që nuk iu është bërë analiza në Prizren dhe e kanë bërë në laboratore private dhe e kanë raportin. Kisha kërku të pranohen edhe raportet e analizave private.

Kryetari – momentalisht i kemi deri 900 raste. Është vendimi që e kemi marrë në Asambleenë Komunale, që stimulohen vetëm ata që vin nga instituti, dhe në të gjitha të dhënat i marrim nga instituti.

Gëzim Kryeziu-Unë personalisht kam mendu që merren parasysh edhe analizat në laboratore private.

Kryetari – ne e zbatojmë vendimin e kuvendit.

Flori Bytyqi - kam shqetësim të shkollës “Destan Bajraktari” ku janë të ndërtuara dy shtëpi dhe ku rrjedh një sasi e ujit. A është e kanalizimit apo e ujësjellësit nuk e di. Duhet të intervenohet nëse është e kanalizimit sepse nxënësat mund të fitojnë ndonjë pandemi lokale.

Kryetari – jep sqarime.

Flori Bytyqi – e kam cek edhe më herët, rruga “Skënderbeu” është e rrezikshme dhe duhet të intervenohet.

Kryetari – e kemi në plan edhe për atë.

Dugagjin Palushi – flet për një konkurs për mësimdhënës në shkollën “Abdyl Rama” në Shirokë ku janë bërë shkelje gjatë procedurave dhe pyet Kryetarin se a është në dijeni. Shumë keqpërdorime po bëhen.

Kryetari – unë nuk di që merren në punë të AAK-së. Merren prej të gjithave, pa dallim. Është komisioni, pyetne edhe drejtorin.

Dugagjin Palushi – ky është vetëm një rast, ka plot tjera.

Dugagjin Palushi – shtegu i ecjes, më 14 janar del publikimi që në vendim anulohet aktiviteti i prokurimit. Pas shumë tentativave për me kurdur këtë tender, kush e mban përgjegjësinë ?

Kryetari – jep përgjigje.

Dugagjin Palushi – Kur përfundon trotuari në Budakovë ?

Kryetari – jep përgjigje.

Dugagjin Palushi – te memoriali i Berishëve një rrugë është në gjendje të keqe, ju kisha lut me intervenu.

Kryetari – jep përgjigje.

Leonard Shala – kam një shqetësim të rrugës e tranzitit ku janë ndal punimet. Është sasi e madhe e dheut që është hequr dhe është e rrezikshme për këmbësorët.

Kryetari – ke të drejtë plotësisht, dhe besoj këtë vit kemi me shku prej Shirokës deri te rruga e Reqanit për kryerjen e pjesës finale.

Xhemajl Kabashi – nuk ka qenë në projekt-vendim, por Kryetari na ka premtu për një kanalizim në fshatim Krushicë e Epërme.

Kryetari – qka t’na mbet në buxhet kemi mu mundu me kry.

Takimi përfundoi: 11:50

Procesmbajtësja; Dafina Haziraj